

# ADINGMARKER

*Lyerje me cilësi të lartë e prodhuar në bazë akrilike, për përpunim dhe shënjim të sipërfaqeve të betonit dhe të asfaltit*

## Fusha e aplikimit:

Adingmarker është i dedikuar për shënjimin të sinjalizimit dhe për mbrojtje dekorative të sipërfaqeve të betonit dhe suvasë. Përdoret në pozita të ekspozuara në ndikesa atmosferike, për pozita me ngarkesa të lehta mekanike, siç janë përpunime të dyshemeve në depo, garazhe, objekte industriale, terrene rekreative-sportive, përpunime përfundimtare të fasadave të sipërfaqet e suvatuara, xhepa të objekteve dhe ngjashëm.

## Cilësi:

- Iyerje një-komponentëshe;
- adezion i mirë për nënshtresën;
- jo-toksik-nuk përmban tretës;
- rezistent në tretje të kripërave dhe vajra minerale;
- rezistent ndaj klorit, acide dhe baza të holluara, tretje të kripërave dhe vajrave minerale;
- rezistent ndaj bakteve;
- rezistent ndaj ujit;
- rezistent në ndikesa atmosferike;
- rezistent në hollim;
- UV stabil;
- në dispozicion në më tepër ngjyra;
- aplikim i thjeshtë dhe i shpejtë;
- i lehtë për mirëmbajtje;

## Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e deklaruar
Dukje	-	Përzjerje e ngjyrosur pastoze
Dendësi	EN ISO 2811-1	(1500±1550) kg/m <sup>3</sup>
Materie e thatë	EN ISO 3251	63-67%
Kohë e tharjes në 20° C	ISO 9117-3	tërësisht (6-8) h në prekje (30-35) min
Periudhë kohore midis dy shtresa në 20° C	-	8 h
Elasticitet i Iyerjes	-	Pa paraqitje të plasaritjeve dhe qërimin
Rezistencë ndaj akullit dhe kripërave	EN 13687-1	Pa paraqitje të plasaritjeve dhe qërimin
Shkëlqim	-	mat

## Metodologjia e realizimit:

### Përgatitje e nënshtresës

Nënshtresa duhet të jetë e fortë, e thatë, e pastër, pa yndyra, pa pluhur, pa prani të kondenzateve dhe me lagështi maksimale prej 7%. Adingmarker është Iyerje e hollë dhe për të fituar dukje e mirë përfundimtare dekorative, nevojitet që përpunimi përfundimtar të jetë me teksturë fine. Temperatura optimale e sipërfaqes në të cilën realizohen punët duhet të jetë në kufijtë prej +50 C deri +350 C, me lagështi relative të ajrit prej 65%.

### Nënshtresë asfalti

Asfalti në të cilin vendoset Iyerja duhet të jetë i shëndoshë, i thatë, i pastër dhe pa pluhur. Pastrimi nga pluhuri duhet të bëhet me ajër nën presion.

### Nënshtresë e re betoni

Betoni duhet të jetë i vjetër 28 ditë, të jetë me fortësi minimale në presion prej 25 MPa. Lëngu i çimentos, mbetjet nga suvaja, ngjyra dhe yndyra duhet të mënjanohet në mënyrë mekanike ose me përdorimin e mjeteve kimike. Më në fund nënshtresës duhet ti mënjanohet pluhuri me thithëse industriale.

## Nënshtresë e vjetër betoni

Nënshtresë e pastër dhe e shëndoshë është parakushti kryesor për arritje të adezionit të shkëlqyer. Njëlloj edhe si te nënshtresë e re e betonit, mënjanimi i lëngut të betonit bëhet në mënyrë mekanike. Yndyrërat që kanë depërtuar në nënshtresën duhet të sanohen me materiale përkatëse për sanim.

## Nënshtresë me lyerje ekzistuese

Adingmarker mund të vendoset në nënshtresa me lyerje ekzistuese, vetëm nëse lyerja, që është përdorur paraprakisht është i fortë në mënyrë të mjaftueshme dhe stabile. Te këto nënshtresa, para vendosjes të lyerjes së re, patjetër duhet të kontrollohet ai adezion midis lyerjes ekzistuese dhe nënshtresës për të parë nëse këto shtresa mund të jenë nënshtresë për lyerjen e re. Nëse adezioni është i dobët, atëherë shtresat e vjetra duhet të mënjanoohen në mënyrë mekanike. Nëse adezioni e shtresave ekzistuese është i mirë, rekomandojmë që sipërfaqet e tyre të përpunohet me zumpare, të mënjanohet pluhuri me procedurë të thatë, e mandej të bëhen fusha provuese, ku në sipërfaqe të caktuara do të vendoset shtresa e re e ngjyrës.

## **Vendosje:**

Para vendosjes së Adingmarker, nënshtresa e cila përpunohet duhet të lyhet me Prajmer V, 30 minuta (në temperaturë prej 20° C) para vendosjes së përpunimit përfundimtar me Adingmarker, me ç'rast nuk guxon të lejohet tharja e saj para vendosjes së përpunimit përfundimtar. Prajmeri vendoset me furçë, cilindër, me makinë me pompë pa ajër (airless). Te nënshtresa me porozitet më të madh, mund të paraqitet nevojë edhe prajmerim të sërishëm.

Adingmarker vendoset në 2 – 3 shtresa, me trashësi të shtresës së thatë prej 150-200µ. Shtresa e parë e Adingmarker hollohet me 10 % ujë të pastër, pas së cilës përzihet me përzierje të ngadalshme deri në homogjenizimin e plotë. Gjatë hollimit të materialit, duhet të kihet kujdes në sasinë, e cila do të hollohet ti përgjigjet sasisë së nevojshme për vendosje të një shtrese të sipërfaqes për përpunim. Shtresa e dytë dhe e tretë vendoset me hollim deri 5%. Distanca kohore e aplikimit midis shtresave, në temperaturë prej 20° C është 8 orë. Sipërfaqet e punuara duhet të mbrohen nga shkujë e fuqishme, shi, akull dhe pluhur në periudhë prej 24-48 orëve. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë më e lartë se 5° C.

## Vendosje makinerike me pompe pa ajër

-presioni (150-200) bar

-diznë (pipëz spërkatëse) 6.35; 7.45; 8.45

-këndi i spërkatjes: në kënd të drejtë në raport me nënshtresën dhe distancë prej 20 – 40 cm.

**Rezëk për jetën:** Prodhimet përbajnë përbërës reaktiv të cilët në gjendje të pa lidhur pjesërisht dëmshëm ndikojnë në shëndetin, Të përdoret pajisje përkatëse mbrojtëse. Në rast të spërkatjes në lëkurë ose në sytë nevojitet shpëlarje me ujë të pastër rrjedhës. Nëse gëlltitet, nevojitet që menjëherë të kërkohet ndihmë mjekësore.

**Zjarr:** Adingmarker nuk mund të.

**Pastrimi dhe vendosja në depo:** Mbetjet e palidhura të Adingmarker pastrohen me ujë. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullativave lokale për atë lloj të mbetjeve.

Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.

## **Paketimi:**

Adingmarker govata plastike: 5 dhe 25 kg Prajmer B govata plastike: 1,5, 10 dhe 20 kg

## **Vendosja në depo:**

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në temperaturë prej 5°C deri 35°C i mbrojtur nga ndikesa e drejtpërdrejtë e rrezeve të diellit. Afati i përdorimit: 9 muaj.

## **Ngjyra standarde:**

RAL1001; RAL1003; RAL1004; RAL1011; RAL1015; RAL1018; RAL1023; RAL1037; RAL2000; RAL2008; RAL3001; RAL3012; RAL3016; RAL3020; RAL4001; RAL5003; RAL5010; RAL5012; RAL5024; RAL6010; RAL6018; RAL6019; RAL6021; RAL6028; RAL6033; RAL7004; RAL7006; RAL7015; RAL7023; RAL7032; RAL7035; RAL7042; RAL7043; RAL7046; RAL8004; RAL9002; RAL9003; RAL9004; RAL9017

**Vërejtje:** RAL ngjyrat e tjera mund të përgatiten në rast të porosisë minimale prej 90 kg.

## **Mirëmbajtje:**

Jetëgjatësia e dyshemesë varet nga mënyra e mirëmbajtja e mirë e saj. Dyshemeja e përpunuar me Adingmarker zakonisht mund të pastrohet edhe me makina me furça të buta rrotulluese, me detergjente të tretura në ujë dhe me acide të holluara ose me ujë të ngrohtë deri 30° C.

## **Shpenzimi:**

Prajmer B	0,15-0,25 kg/m <sup>2</sup>
Adingmarker për dy shtresa	0,40-0,50 kg/m <sup>2</sup>
Për tre shtresa	0,50-0,60 kg/m <sup>2</sup>

## **Pastrimi:**

Veglat dhe pajisja pastrohet me ujë, menjëherë pas përdorimit.